



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 122, Datë 06.05.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“PREMIUM GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1233/1 prot., datë 04.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1233 prot., datë 21.04.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “b” dhe “c”; për pikën 2.4, gërmat “a” dhe “b”.
- Aplikuesi duhet të plotësojë dhe informacionin/dokumentacionin si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penaltetit) për vetë shoqërinë.

- Në kuadër të gërmës “c” shoqëria ka depozituar organigramën e saj dhe ka bërë me dije se kjo strukturë organizative nuk është ende efektive, por parashikohet të bëhet e tillë me hyrjen në treg dhe zgjerimin progresiv të portofolit të klientëve. Në këto rrethana, vlerësohet që në rast licencimi t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE strukturën organizative përfundimtare në momentin e fillimit të ushtrimit efektiv të veprimtarisë.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”:** Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimet që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- **gërma “b”:** Duke qenë se kontrata e shërbimit e depozituar nuk mbulon të gjithë afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet të bëhet sqarimi përkatës me shoqërinë me qëllim depozitimin e një dokumenti që mbulon të gjithë afatin e licencës ose vlerësimin në vijim të një licencimi me kusht.
- **gërma “c”:** Duke qenë se kontrata për disponimin e zyrave të ushtrimit të aktivitetit të furnizuesit nuk mbulon të gjithë afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet të bëhet sqarimi përkatës me shoqërinë me qëllim depozitimin e një dokumenti që mbulon të gjithë afatin e licencës ose vlerësimin në vijim të një licencimi me kusht.
- **gërma “d”:** Aplikuesi duhet të japë informacion dhe në lidhje me mënyrën e matjes së energjisë elektrike për klientët.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI